



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS PODUJEVË

Numri i lëndës: 2024:197812

Datë: 14.03.2025

Numri i dokumentit: 06990482

C.nr.1713/24

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEGA NË PODUJEVË Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, me gjyqtarin Binak Duqi dhe bashkëpunëtorin profesional Muhamet Musliu, në çështjen juridike kontestimore të paditësit I. F. me nr personal ... nga P., të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve “K. & A.” me avokatët e saj S. K. etj., nga P., Lagjja U., C-..., ..., me autorizim,, kundër të paditurës Komuna e Podujevës - Drejtoria Komunale e Arsimit, lidhur me çështjen kontestuese kompensimin e diferencës në pagë në emër të kualifikimit (licencimit), jashtë seance, me datë 14.03.2025, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET NË TËRËSI SI E PABAZUAR kërkesëpadia e paditësit I. F. nga P. me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura Komuna e Podujevës - DKA që paditeses në emër të kërkeses mbi bazën e kualifikimit t’ia paguaj 27% në pagën bazë për periudhën kohore nga data 06.02.2023 e në vazhdim, me kamatë ligjore prej 8% në vit, nga dita e parashtrimit të padisë e deri ne pagesën perfundimtare, në afat prej 7 ditësh nga dita e plothuqishmërisë së aktgjykimit nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi I. F. përmes të autorizuarit të tij, në këtë gjykatë me datë 12.07.2024, ka parashtruar padi kundër të paditurës, me objekt kontesti kompensimin e shtesës në pagë mbi bazën e kualifikimit – licencimit. Në padi ka theksuar se me hyrjen në të Ligjit 08/L-196 për pagat në sektorin publik paditësi nuk është kompensuar për shtesën në emër të kualifikimit sipas Vendimit nr. 01/33 i datës 29.08.2008. Më tej ka theksuar me nxjerrjen e Aktgjykimit nga Gjykata Kushtetuese nr. ref.: AGJ 2316/24, KO79/23 të datës 23.01.2024 ka shfuqizuar nenin 45 par. 2 të Ligjit për pagat në sektorin publik, tani paditësit i takon shtesa në emër të kualifikimit si përcaktohet me Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës me numër 01/33 të datës 29.08.2008. Tutje i ka propozuar gjykatës që të aprovohet kërkesëpadia e paditësit dhe të detyrohet e paditura që paditësit t’i paguajë shtesat në emër të kualifikimit në lartësi prej 27 % të pagës bazë, nga data

06.02.2023 në vazhdim, të gjitha me kamatë ligjore prej 8% nga dita e paraqitjes së padisë. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar sipas Tarifave të OAK - së.

E paditura në përgjigjen në padi të dhënë pranë kësaj gjykate me datë 12.03.2025 e ka kontestuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit për kompensimin e kualifikimit sipas Vendimit të QRK-së të dt.29.08.2008 me arsyetimin se nga data 06.02.2023 ka hyrë në fuqi Ligji për Zyrtarët Publik dhe diferenca e përcaktuar sipas vendimit të lartë cekur është inkorporuar në pagën e mësimdhënësve. Më tej shton se me hyrjen në fuqi të Ligjit për Zyrtarët Publik tanimë nuk kemi pagë bazë për kategorinë e të punësuarve në sektorin e arsimit por sikurse të të gjithë të punësuarit në sektorin publik në Republikën e Kosovës, edhe paga e tyre është e rregulluar me anë të koeficientit, kështu që për të punësuarit në arsimin e mesëm të ultë koeficienti është 5.6, ndërsa për arsimin e mesëm të lartë koeficientit është 5.8, dhe se konsiderojmë se paditësi shtesat në pagë i realizon sipas Ligjit nr.08/L196 për pagat në sektorin publik. Prandaj i ka propozuar gjykatës që duke u bazuar në faktet e theksuara, pas administrimit të provave kërkesëpadinë e paditësit ta refuzoj në tërësi si të pa bazuar. Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Me rastin e pranimit të përgjigjes në padi, gjegjësisht vlerësimit të pretendimeve të palëve ndërgjyqëse e në lidhshmëri me vlerësimin e provave të bashkangjitura, kjo Gjykatë erdhi në përfundim se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, rrjedhimisht nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit meritore pa caktuar fare seancë gjyqësore në kuptim të dispozitës nga neni 399 par.1 të LPK-së, e cila përcakton: *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritore me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia.”*

Nga shqyrtimi i shkresave të lëndës dhe vlerësimi i përgjigjes në padi, gjykata konstatoi se në mes të palëve ndërgjyqësve nuk është kontestuese se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura sipas kontratë së punës me nr. prot.... e datës 01.09.2019 e lidhur në mes të paditësit dhe të paditurit.

Nga diploma Universitare me numër ... e datës 15.09.2014 e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës , gjykata e vërtetoi faktin se paditësi ka mbaruar studimet në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike dhe kompjuterike në Prishtinë me datë 30.07.2014 dhe ka marrë titullin Bachelor i Shkencave të Inxhinierisë Kompjuterike.

Nga licenca me numër ... e datës 26.10.2016 gjykata vërtetoi faktin se paditësi I. F. është e licensuar që nga data 26.10.2016 e deri me datë 26.10.2021. Gjykata ka vërtetuar faktin se licenca e paditës është licencë e rregullt e karrierës.

Fakt vendimtar për tu vërtetuar në këtë çështje kontestimore ishte nëse paditësit i takon kompensimi i pretenduar në emër të kualifikimit pas hyrjes në fuqi të Ligjit për Pagat në Sektorin Publik, përkatësisht nga data 06.02.2023.

Fillimisht Gjykata gjen se me Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës numër 01/33 të datës 29.08.2008 nga 1 shtatori 2008 të gjithë mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe

bashkëpunëtorët profesional në shkollat e Republikës së Kosovës do të kenë rritje të pagave të tyre në bazë të kriterëve të licencimit. Tutje, ky vendim ka përcaktuar se nga 1 shtatori 2008, përmes licencimit zëvendësohet sistemi linear i pagave përmes dallimeve pozitive të pagave për të gjithë mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional në shkollat e Republikës së Kosovës në nivelin fillor dhe atë të mesëm.

Me datë 05.02.2023, ka hyrë në fuqi Ligji 08/L-196 për pagat në sektorin publik. Në nenin 1 [Qëllimi] ky Ligj ka përcaktuar se *qëllimi i këtij ligji është që të krijojë një sistem të njëtrajtshëm të pagave në sektorin publik që përfshin parimet dhe rregullat për përcaktim të pagës në sektorin publik si dhe të krijojë një sistem të pagave dhe shpërblimeve, transparent dhe të menaxhueshëm ku elementi kryesor është paga bazë.*

Tutje, Ligji në nenin 3 par. 1 nën par. 1.9 ka përkufizuar pagën bazë si vijon: *“paga bazë – nënkupton elementin kryesor fiks të kundërvlerës monetare mujore që i përgjigjet nivelit të kompleksitetit të funksionit, pozitës apo gradës dhe nivelit të kualifikimit të kërkuar për atë funksion, pozitë apo gradë, në përputhje me shtojcat e këtij ligji;”*

Më tej, në nenin 29 par. 1 të Ligjit është përcaktuar se *Nëpunëset/it e arsimit para universitar mund të marrin shtesën për licencë të avancuar. Shtesa për licencë të avancuar nuk nënkupton licencën e nivelin bazik që njihet si licencë e karrierës e që është kusht për ushtrimin e profesionit.*

Gjykata konstaton se Vendimi i Qeverisë numër 01/33 i datës 29.08.2008 në kohën e hyrjes së tij në fuqi ka ngritur pagat e nëpunësve të arsimit para universitar (mësimdhënësve, drejtorëve (zëvendësdrejtorëve) dhe bashkëpunëtorëve profesional në shkollat e Republikës së Kosovës në nivelin fillor dhe atë të mesëm), ashtu që përmes licencimit është zëvendësuar sistemi linear i pagave përmes dallimeve pozitive të pagave. Pra, ngritja e pagave për këtë kategori është bërë me vendim qeveritar, për shkak të mungesës së një ligji për pagat në sektor publik.

Me hyrjen në fuqi të Ligjit për pagat në sektorin publik me datë 05.02.2023, është krijuar një sistem i njëtrajtshëm i pagave në sektorin publik, ku përfshihen edhe nëpunësit e sistemit arsimor para universitar. Së këndejmi, me këtë ligj është përcaktuar paga bazë edhe për nëpunësit e sistemit arsimor para universitar e cila i përgjigjet nivelit të kompleksitetit të funksionit, pozitës apo gradës dhe nivelit të kualifikimit të kërkuar për atë funksion, pozitë apo gradë. Në këtë kuptim, Vendimi i Qeverisë numër 01/33 i datës 29.08.2008 ka zëvendësuar sistemin linear të pagave me rastin e hyrjes së tij në fuqi. Megjithatë, me hyrjen në fuqi të Ligjit për pagat në sektorin publik, është krijuar sistem i ri i pagave, ku është përcaktuar paga bazë. Andaj, duke qenë se në pagën bazë të nëpunësve të arsimit para universitar është përfshirë edhe kualifikimi i kërkuar për ushtrimin e funksionit, gjykata konstaton se nga provat e shqyrtuara nuk rezulton themelësia e kërkesëpadisë së paditësit.

Për më tepër, Gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi ka nivel të rregullt të licencës, gjegjësisht licencë të rregullt të karrierës të lëshuar për pesë vite nga data 26.10.2016 e deri me datë 26.10.2021 siç konstatohet nga vetë titulli i licencës, të cilat përjashtohen nga kompensimi ashtu

ashtu siç përcaktohet me Ligjin për pagat në sektorin publik, përkatësisht nenit 29 par. 1. Andaj, duke qenë se paditësi ka licencë të rregullt, përkatësisht bazike, e cila shërben si kusht për ushtrimin e profesionit në arsimin para universitar, dhe jo licencë të avancuar të karrierës, Gjykata konstaton se paditësit nuk i takon kompensimi në pagë mbi bazën e kualifikimit - licencimit nga hyrja në fuqi e Ligjit për pagat në sektorin publik, përkatësisht nga data 06.02.2023.

Së këndejmi, gjykata ka vendosur që kërkesëpadinë e paditësit ta refuzojë në tërësi si të pabazuar si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Vendimin nga pika II e dispozitivit që secila palë të bartë shpenzimet e veta procedurale, gjykata e bazoi në nenin 450 të LPK-së.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura e konform nenit 399 të LPK-së, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - DEGA NË PODUJEVË
Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil
C.nr.1713/24 datë 14.03.2025.

Gjyqtari
Binak Duqi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së te njëjtit, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.